



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

Nr. Serial: 000009

LEJE
PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS- SHPIMI)

Nr. 5/13 Prot., datë 17/12/21

Miratur me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR ERZEN

Nr. 8, datë 10.12.21

Emri i individit/subjektit: **“Pastrime Silvio” sh.p.k**
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): **K91413010N**
Baseni Ujor: **Erzen**
Qarku: **Tiranë**
Bashkia/ Njësia administrative: **Tiranë**
Akuiferi (që kërkohet të shfrytëzohet) **Akuiferi me porozitet poro-çarje me ujëmbajtje të ulët.**

Vendndodhja e Shpimit (Koordinatat KRGJSH) :

X = 487087.936 Y = 4573383.399 Z = 150 m.m.n.d

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **Për ujitje**

Thellësia e parashikuar në m: **150 m**

Diametri 1 (m) **0.3 m** Thellësia nga **0m** në **5m**

Diametri 2 (m) **0.25 m** Thellësia nga **5m** në **150m**

Diametri 3 (m) - Thellësia nga - në -

Lloji i shpimit: **Shpim në shtresë pa presion, në nivel të lirë**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas kushteve të lejes**

Periodha e vlefshmërisë: **5 VJET**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.**

KRYETARI

AFRIM QËNDRO



Kushtet e posaçme të lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus–shpimi)

1. Të realizojë shpimin dhe punimet e tjera hidrogeologjike duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me veprimtarinë;
3. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
4. Të dorëzojë pranë AMBU-së, brenda 1 muaji nga hapja e pusit raportin hidrogeologjik, me konstatimet dhe konkluzionet përkatëse;
5. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
6. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
7. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
8. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujqor;
9. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
10. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti.
11. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjendjen e mëparshme.
12. Të mos cënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
13. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë.
14. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.